

## SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Metodat kërkimore</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. As. Dr. Artan Veseli</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:artan.veseli@ushaf.net">artan.veseli@ushaf.net</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Lënda Metodat Kërkimore përgatit studentët në fushën e kërkimeve shkencore dhe projekteve hulumtuese. Kjo lëndë është dizajnuar për t'i prezantuar studentët me logjikën e metodave të kërkimit në shkencat shoqërore. Klasat dhe tutorialet javore synojnë t'u japin studentëve një kuptim bazë të metodave të kërkimit në shkencat shoqërore dhe në këtë proces, t'i përgatisin ata për të shkruar propozimet e tyre kërkimore. Ligjeratat fokusohen në çështjet shumë themelore të metodave të kërkimore, si identifikimi dhe gjenerimi i ideve kërkimore, formulimi i qëllimit, objektivave dhe pyetjeve kërkimore dhe rishikimi i literaturës për përgjigjet që studiuesit kanë ofruar deri më tani. Gjithashtu, ligjeratat fokusohen në metodologjinë e hulumtimit, më konkretisht natyrën e kërkimit cilësor dhe sasior, si dhe filozofitë që qëndrojnë në themel të tyre dhe demonstrojnë se si ato mund të jenë shumë mirë plotësuese me njëra-tjetrën në prodhimin e njohurive.</p>
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kësaj lënde është përgatitja e studentëve në fushën e metodave kërkimore-shkencore, që do t'u shërbejë atyre për t'ua lehtësuar përgatitjen e projekteve kërkimore dhe punën kërkimore-shkencore në përgjithësi (gjatë kohës së studimeve, por edhe pas përfundimit të studimeve).</p>

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të suksesshëm të lëndes, studentët duhet të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohin konceptet, gjuhën, metodat dhe aplikimet e metodave kërkimore;</li> <li>• Zhvillojnë aftësi për të formuluar pyetje të qarta kërkimore;</li> <li>• Zhvillojnë aftësi për të identifikuar një dizajn të përshtatshëm kërkimi për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore dhe për të kontribuar në njohuritë e përgjithësueshme;</li> <li>• Mësojnë se si të vlerësohen pikat e forta dhe të dobëta të dizajnit të kërkimit në çdo studim të caktuar;</li> <li>• Demonstrojnë bazat teorike të qasjes së tyre të zgjedhur;</li> <li>• Përdorin bibliotekat dhe burimet elektronike dhe gjejnë materialet e duhura;</li> <li>• Shkruajnë një projekt propozimi kërkimor të detajuar, të realizueshëm dhe rigoroz.</li> </ul>
---	---

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren (vizitë studimore)			
Kollokfiume, seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezentimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>125</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Kjo lëndë do të zhvillohet në kohëzgjatje prej 15 javësh, me 2 orë ligjerata në javë, ku do të trajtohen tema të ndryshme të metodave kërkimore dhe 1 orë në klasë ushtrime në grup.
-------------------------------------	--

	<p>Ustrimet do të mbahen në grup ku rastet reale do të analizohen dhe diskutohen në grup. Studentët do t'i nënshtrohen vlerësimit në fund të ciklit të plotë të këtij kursi me një punim seminarik (projekt propozim për hulumtim).</p>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Punim seminarik (projekt propozim për hulumtim) 100%. Udhëzimet e detajuara për zhvillimin e Projekt Propozimit do të publikohen në platformën SMU në fillim të semestrit. Studentët do të kenë mundësi të zgjedhin njërën nga opsionet e mundshme për projekt propozim, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Projekt Propozim për Konsulencë të Aplikuar, ose</li> <li>Projekt Propozim Experimental-Shkencor, ose</li> <li>Projekt Propozim Konceptual-Teorik.</li> </ol>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p>Matthews, B. dhe Ross, L., (2010), Metodat Hulumtimit: Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Qendra për Arsim Demokratik: Tiranë</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>Saunders, M. N. K., Lewis, P., &amp; Thornhill, A. (2012). Research methods for business students (6th Edition) Harlow, England: Pearson Education</p>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Ç'është hulumtimi</b> (pse bëhet hulumtimi; përkufizimet e hulumtimeve; karakteristikat e hulumtimit; cilësia në hulumtime; kush janë hulumtuesit në fushat shoqërore)</li> <li>• <b>Dijet, teoritë, paradigmat dhe këndvështrimet</b> (ç'është hulumtimi; cila është natyra e subjektit të hulumtimit shoqëror – ç'është bota shoqërore; ontologjia dhe epistemologjia; çfarë është dija/njohuritë; pesë mënyrat e të diturit; si na ndihmojnë teoritë kur kryejmë hulumtime në fushat shoqërore )</li> </ul>
<b>Java e dytë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Natyrat e të dhënave</b> (karakteristikat e të dhënave; përdorimi i të dhënave si pëfaqësim i realitetit shoqëror; cilësia e të dhënave)</li> <li>• <b>Pyetjet e hulumtimit, hipotezat dhe përkufizimet operative të hulumtimit</b> (çfarë janë pyetjet e hulumtimit; planifikimi dhe bërja e pyetjeve të hulumtimit; llojet e pyetjeve të hulumtimit; hartimi i pyetjeve të hulumtimit dhe i përkufizimeve operative)</li> <li>• <b>Hulumtimi si çështje etike dhe kulturore</b> (miratimi etik; leja e informuar; mbrojtja nga lëndimi; grupet e rrezikuara; marrja parasyshe e</li> </ul>

	traditave dhe diversitetit në kërkim shkencor)
<b>Java e tretë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Planifikimi i nje projekti hulumtues</b> (planifikimi i projektit hulumtues; përkufizimi i hulumtimit; gjenerimi i ideve të cilat ndihmojnë në zgjedhjen e një hulumtimi të përshtatshëm; identifikimi i attributeve të cilat e bëjnë një hulumtim të mirë; shëndrrimin e ideve në një projekt hulumtues i cili ka pyetje dhe objektiva të qarta hulumtuese; formulimi i propozimit të hulumtimit)</li> </ul>
<b>Java e katërt:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Rishikimi kritik i literaturës</b> (rëndësia dhe qëllimi i rishikimit kritik të literaturës; adaptimi i një perspektive kritike në leximin e literaturës; çfarë të përfshihet gjatë shkrimit të literaturës; burimet e literaturës primare; sekondare dhe terciare; shqyrtimi i rëndësisë; vlerës dhe mjaftueshmërisë së literaturës në dispozicion; referencimi me saktësi i literaturës; çfarë nënkupton plagjiarizmi)</li> </ul>
<b>Java e pestë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Udhëzimet e stilit të shkrimit APA</b> (formatimi i një punimi kërkimor në stilin APA; formatimi faqes së referencave; shembuj të referencimit si libra, artikuj revistash, teza dhe disertacione, media dixhitale dhe përmbajtje në internet, media sociale, forume diskutimi në moodle, komunikime personale, kur informacioni mungon; aplikimi i citimeve në një punim si citime të sakta apo parafrazimi i koncepteve)</li> </ul>
<b>Java e gjashtë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kuptimi i filozofive dhe qasjeve kërkimore</b> (kuptimi i filozofive kërkimore; ontologjia: natyra e realitetit, objektivizmi, subjektivizmi; epistemologjia: çfarë konsiderohet njohuri e pranueshme, pozitivizmi, realizmi, interpretivizmi; aksiologjia; paradigmë kërkimore; qasjet kërkimore: deduksioni, induksioni, abduksioni; përdorimi i qasjeve kërkimore në kombinim)</li> </ul>
<b>Java e shtatë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Formulimi i dizajnit të hulumtimit</b> (zgjedhja dhe koherenca në hartimin e kërkimit; zgjedhja e një dizajni kërkimor me metoda sasiore, cilësore ose të shumëfishta; njohja e natyrës së dizajnit të kërkimit; studimet përshkruese dhe shpjeguese; zgjedhja e një strategjie kërkimore si: eksperimenti, kërkimi arkivor, rasti studimor, etnografia, kërkimi në veprim, dhe teoria e bazuar; zgjedhja e horizontit kohor; vendosja e etikës së dizajnit të kërkimit; vendosja e cilësisë së dizajnit të kërkimit)</li> </ul>
<b>Java e tetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Zgjedhja e kampionit</b> (qasjet e kampionimit; kampionimi statistikor ose kampioni i probabilitetit; kampionët e rastësishëm dhe ata të shtresëzuar; kontrolli i cilësisë së hulumtimit: kampionët e probabilitetit dhe përgjithësueshmëria, kampionimi jo-probabilitar; kontrolli i cilësisë së hulumtimit të kampionët jo-probabilitarë; kampionimi i</li> </ul>

	qëllimshëm; kampionimi i teorik; zgjedhja e qasjes së kampionimit)
<b>Java e nëntë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përdorimi i të dhënave dytësore</b> (llojet e të dhënave dytësore; të dhënat dytësore nga dokumentarët; të dhënat dytësore nga anketat; të dhënat dytësore shumë burimore; gjetja e të dhënave dytësore; avantazhet dhe disavantazhet e të dhënave dytësore; shqyrtimi i të dhënave dytësore; shqyrtimi i burimeve të të dhënave dytësore)</li> </ul>
<b>Java e dhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mbledhja e të dhënave parësore përmes intervistave gjysëm të strukturuar, të pastrukturuar, dhe grupore</b> (llojet e intervistave dhe lidhja e tyre me strategjinë e hulumtimit; përdorimi i intervistave gjysëm të strukturuar dhe të pa-strukturuar; çështjet e cilësisë së të dhënave në intervistat gjysëm të strukturuar dhe ato të pa-strukturuar; pregaditja dhe kryerja e intervistave gjysëm të strukturuar dhe të pa-strukturuar; përdorimi i duhur i llojeve të ndryshme të pyetjeve; menaxhimi i resurseve dhe i çështjeve logjistike; intervistat grupore dhe grupet e fokusit)</li> </ul>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mbledhja e të dhënave parësore përmes pyetësorëve</b> (kur përdoret pyetësi; llojet e pyetësorëve; zgjedhja e pyetësorëve; hapat për pregaditjen e pyetësorit, mbledhja e të dhënave esenciale; dizajnimi i pyetësorëve; dizajnimi i pyetjeve individuale; ndërtimi i pyetësorëve; pilot testimi i pyetësorit; shpërndarja dhe mbledhja e pyetësorëve; anketat përmes telefonit; intervistat e strukturuar)</li> </ul>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mbledhja e të dhënave primare përmes vëzhgimit</b> (çfarë është vëzhgimi i pjesëmarrësve; faktorët që përcaktojnë zgjedhjen e rolit të vëzhguesit pjesëmarrës; mbledhja dhe analiza e të dhënave; çështjet dhe kërcënimet që lidhen me besueshmërinë dhe vlefshmërinë)</li> </ul>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Analiza e të dhënave sasiore</b> (përgatitja, futja dhe kontrollimi i të dhënave sasiore; llojet e të dhënave sasiore; përcaktimi i llojit të të dhënave; paraqitja e të dhënave; kodimi i të dhënave; futja e të dhënave; eksplorimi dhe prezantimi i të dhënave; eksplorimi dhe prezantimi i variablave individuale; përshkrimi i të dhënave duke përdorur modelet statistikore; ekzaminimi i marrëdhënies, diferencave dhe trendeve duke përdorur statistikat; vlerësimi i forcës së marrëdhënies)</li> </ul>
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Analiza e të dhënave cilësore</b> (karakteristikat e të dhënave cilësore; qasja e analizimit induktive vs deduktive; pregaditja e të dhënave</li> </ul>

	<p>tuaja për analizë; qasjet e përgjithshme të analizës, kategorizimi i të dhënave; krijimi i njësive; njohja e mardhënieve dhe zhvillimi i kategorive; zhvillimi i propozimeve të testueshme, natyra interaktive e procesit; raportimi i rezultateve i të dhënave cilësore; kuantifikimi i të dhënave cilësore; paraqitja dhe analiza e të dhënave; analiza tematike; analiza e rrëfimeve; analiza e ligjërimit; analiza e përmbajtjes; teoria e bazuar)</p>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Shkrimi dhe prezantimi i raportit të projektit</b> (fillimi me shkrim; strukturimi i raportit të projektit; organizimi i përmbajtjes së raportit të projektit; zhvillimi i një stili të përshtatshëm të shkrimit)</li> </ul>
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<p>Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.</p>	